

FATMIR GASHI

Zëvendësministër i Financave

Më 30 tetor 2017 Fatmir Gashi u emërua Zëvendësministër i Financave i Republikës së Kosovës.

Funksione tjera të cilat i ka ushtruar Fatmir Gashi para marrjes së mandatit të Zëvendësministrit të Financave janë: më 1 gusht 2013 u emërua Zëvendësgovernator i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës. Këtë post e ushtroi deri më 31 dhjetor 2016.

Më 1 nëntor 31 korrik 2013 u emërua Drejtor gjeneral i Kompanisë së Sigurimeve Dardania, ku detyrë kryesore kishte organizimin dhe udhëheqjen e kompanisë.

Nga viti 2002 deri më 15 tetor 2006 ushtroi detyrën e Zëvendësdrejtorit të Përgjithshëm në Kompaninë e Sigurimeve Dukagjini, ku si funksion kryesor kishte menaxhimin e financave dhe menaxhimin e departamenteve tjera.

Ndërsa, nga data 16 tetor 2006 deri më 5 tetor 2011 u emërua Drejtor Gjeneral në Kompaninë e Sigurimeve Dukagjini-Ilyria, ku gjatë kësaj periudhe organizoi dhe udhëhoqi punët e kompanisë.

Në periudhën 2001-2002 ushtroi detyrën e Inspektorit të Përgjithshëm në BPK (Autoriteti Bankar dhe i Pagesave Banking) ku në mandatin e tij si funksion bazë kishte revizionin e funksionimit të kontrollës së brendshme në BPK. Gjatë këtyre dy viteve u zbatua kalimi i valutës në euro dhe njëri prej përgjegjësve kryesorë në këtë proces ishte z.Gashi.

Paraprakisht që nga viti 1999-2001 në po të njëjtin institucion (BPK) ushtroi detyrën e Drejtorit, dega në Pejë. Aktivitete kryesore kishte punët menaxhuese në BPK-Dega në Pejë lidhur me përdorimin e CASH-it.

Nga viti 1991-1998 z.Gashi u emërua si Inspektor i Lartë në Shërbimin e Kontabilitetit Shoqëror – SHKSH ku si funksion kryesor kishte mbikëqyrjen e bankave dhe kompanive të mëdha ekonomike.

Më 3 shtator 1990 u suspendua nga puna për shkak të grevës së sindikatës. U kthye në punë në vitin 1991 pas shqyrtimit të Komisionit Disiplinor si punëtorë në SHKSH.

Në po të njëjtin institucion më herët kishte ushtruar edhe detyra tjera si:

- Inspektor gjatë periudhës 1981-1989, ku si funksion kishte kontrollimin e deklaratave financiare të kompanive, si dhe
- Zëvendësdrejtor, dega në Pejë nga viti 1989-1990, ku detyrë kryesore kishte punët menaxhuese dhe mbikëqyrëse të transaksioneve financiare, pagesave dhe sektorit të kontrollës.

Punë shtesë :

- Nga viti 1992-1999 ka qenë anëtar i Këshillit Qendror për Financim të Kosovës – Këshilli Komunal për Financim- Pejë;
- Nga maji i vitit 2007 - maj 2011 ka qenë Kryetar i Bordit Kosovar mbi Standardet Financiare;
- Kryetar i Këshillit Kosovar për Raportim Financiar 2011-2013;
- Kryetar i Federatës së Basketbollit të Kosovës nga viti 2010-2013;
- Kryetar i Bordit të Fondit të Garancisë së Kosovës 2008-2010;
- Anëtar i Bordit Mbikëqyrës të Fabrikës së Birrës në Pejë 2011-2014;
- Anëtar i Këshillit Administrativ të Byrosë Kosovare të Sigurimeve 2011-2013.

Fatmir Gashi diplomoi në vitin 1981 në Fakultetin Ekonomik në Universitetin e Prishtinës, si dhe studimet master i përfundoi në Ekonomik - Sigurime.

Zëvendësministri Fatmir Gashi është i lindur më 4 mars 1956 në Pejë.

Jeton në Pejë me bashkëshorten Ilirjanen dhe ka dy fëmijë dhe dy nipa.